Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: 383 38 312 309 email: oshp@rks-gov.net

RAPORTI I EKSPERTIT SHQYRTUES

Eksperti Shqyrtues	Data e autorizimit të ekspertit	Date e dorëzimit të raportit	Nr. i lëndës
Majlinda Bedrolli	**27.10.2023**	**09.11.2023**	**2023/0798**

BAZA LIGJORE E SHQYRTIMIT

Me datën: 16.10.2023, OE “Petrol Company - SH.P.K.”- Prishtinë, ka parashtruar ankesë me nr: 2023/0798, kundër njoftimit për dhënie të kontratës ku është rekomanduar për kontratë **(Lot 2**) OE "Wood Company"- SH.P.K.”, lidhur me aktivitetin e prokurimit: “Furnizim me lend djegese - Dru dhe Pelet LOT 1- Furnizim me lend djegese - Dru **LOT 2- Furnizim me lend djegese - Pelet”** me nr. të prokurimit: "635-23-8135-1-1-1", iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – KOMUNA E PEJES.Autoriteti kontraktues ka zbatuar procedurë të hapur, kontratë publike kornizë-furnizim, vlera e parashikuar e kontratës: 340.000.00 Euro vlera totale e 2 Loteve , LOT 1- Furnizim me lënd djegëse – Dru Vlera : 240.000.00 Euro, LOT 2- Furnizim me lënd djegëse- Pelet Vlera: 100.000.00 Euro.Konform nenit 113, 114 të Ligjit Nr. 04 / L - 042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04 / L - 237, Ligjin 05 / L - 068, dhe Ligjin 05 / L - 092, Eksperti Shqyrtues i ka shqyrtuar pretendimet ankimore të OE ankues.

DISPOZITAT E SHKELURA DHE PRETENDIMET ANKIMORE

Neni 7 Barazia në Trajtim/ Jo- Diskriminimi i LPP

Neni 6 Ekonomiciteti dhe Efikasiteti

Neni 59 Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahasimi i Tenderëve i LPP

Neni 60 Kriteret për Dhënien e Kontratës i LPP

Neni 72 Dokumentacioni dhe informacioni shtesë i LPP, respektivisht Neni 38 Sqarimi i Tenderëve i A01 Rregullores 01/2022 se Prokurimit Publik

Neni 1 Qellimi

Neni 1 Qellimi- 1. Qëllimi i këtij ligji është të siguroj mënyrën më efikase, më transparente dhe më të drejtë të shfrytëzimit të fondeve publike, burimeve publike si dhe të gjitha fondeve dhe burimeve të tjera të autoriteteve kontraktuese në Kosovë duke përcaktuar kushtet dhe rregullat që do të zbatohen, procedurat që do të ndiqen, të drejtat që do të respektohen dhe detyrimet që do të përmbushen nga personat, operatorët ekonomik, ndërmarrjet, autoritetet kontraktuese etj-**Konsiderojme se AK Komuna e Pejes ka bere shkelje te dispozitave te nenit 1 te LPP-se pasi ka shpreblyer me kontrate nje OE i cili ka ofruar cmimin me te larte se oferta jone ne konzorcium edhe pse ne kemi ofruar tender te pergjejgshem ne pershtatje me kerkesat e dosjes se tenderit dhe njoftimin per kontrate. Me kete rast Ak ka shkelur qellimin e Ligjit te Prokurimit i cili ka per qellim sigurimin e vleres per parane.AK me fjale te tjera tenton**

eleminimin e ofertes tone edhe pse jane dorzuar lista e furnizimeve dhe kontrata per furnizm me derivate dhe PELET dhe eshte e bashkangjitur edhe Rererenca per furnizim me derivate dhe PELET dhe aryestimi i eleminit te kompanis tone kinse nuk kemi bashkangjitur kontrat dhe referenc te natyres se njejte AK shkel parimin e konkurences dhe tregun e lire dhe shkel parimet e prokurimit publik qe kane te bejne me transparencen dhe ekonomicitetin perkatesisht ruajtjenm e parase publike sikur eshte parapare ne nenin 1 te LPP-se.

Neni 7 Barazia në Trajtim/ Jo- Diskriminimi i LPP përcakton "*7.1 Autoriteti kontraktues do ti **trajtoj operatorët ekonomik në mënyrë të barabartë dhe jo- diskriminuese dhe do të veprojë në mënyrë transparente**. **Ndërsa 7.6** "Gjatë udhëheqjes së aktiviteteve të prokurimit, të gjitha autoritetet kontraktuese do të sigurojnë; (i) pjesëmarrjen sa më të gjerë të mundshme të operatorëve të interesuar ekonomik lidhur me çmimin dhe lëndën e prokurimit; (ii) publikimin e rregullt, dërgimin dhe/ose disponueshmërinë e të gjitha njoftimeve, ftesave, informacioneve dhe dokumenteve që kanë të bëjnë me aktivitetin e prokurimit në përputhje me këtë ligj; (iii) eliminimin e praktikave, kritereve, kërkesave dhe specifikimeve teknike që diskriminojnë në favor ose kundër një ose më shumë operatorëve ekonomik; **(iv) që të gjitha specifikimet teknike dhe të gjitha kërkesat për përzgjedhje dhe dhënie, duke përfshirë rëndësinë relative të secilës kërkesë dhe kriter të tillë, si dhe metodat e përzgjedhjes dhe dhënies të saktësohen në njoftimin e kontratës ose konkursit përkatës të projektimit, në ftesën për tender ose pjesëmarrje dhe/ose në dosjen e tenderit; (v) që asnjë kërkesë, kriter, specifikim që nuk është saktësuar kështu, të mos përdoret në procesin e përzgjedhjes ose dhënies, dhe (vi) që tenderi i zgjedhur të përputhet me të gjitha aspektet përmbajtjesore të kushteve, kritereve dhe specifikimeve përkatëse***".

Konsiderojmë se Komuna e Pejes ka shkelur nenin 7 (diskriminimin) te LPP sepse ka diskriminuar Kompaninë tone duke propozuar me shpërblim për Kontrate OE i cili ka oferten me cmimin me te larte se oferta jone. Gjithashtu Komuna e Pejes ka diskriminuar OE ne kozorcium duke i eleminuar kinse nuk keni prezentuar kontrata tjera qe kane te bejne me natyren e pune per furnizim me Pelet.

Prova: Lista e Furnizmeve dhe Refrenca ne emer te DHF-se ku eshte i cekur furnizime me derivate dhe PELET

Neni 59 Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahasimi i Tenderëve i LPP përcakton "

Konsiderojmë se Komuna e Pejest ka shkelur ketë nen sepse ka propozuar për shpërblim me kontratë Operatorin ekonomik i cili ka oferten me te larte se OE ne konzorcium.

Neni 60 "Kriteret për Dhënien e Kontratë" përcakton *"Autoriteti kontraktues do t'ia jap kontratën publike operatorit ekonomik që ka dorëzuar* ***Tenderin e përgjegjshëm me çmimin më të ulët;***

Konsiderojmë se Komuna e Pejes ka shkelur ketë nen sepse ka propozuar për shpërblim OE me

cmim me te larte se Oferta jone.

Neni 72 Dokumentacioni dhe informacioni shtesë i LPP, përcakton "*Kur informacioni apo dokumentacioni që duhet të dorëzohet nga operatorët ekonomikë është ose duket të jetë jo i plotë ose i gabuar, ose kur mungojnë dokumentet specifike, autoritetet kontraktuese mund të kërkojnë nga operatorët ekonomikë qe të dorëzojnë, plotësojnë, sqarojnë apo kompletojnë informacionin apo dokumentacionin e duhur brenda një afati te caktuar kohor, me kusht që kërkesat e tilla bëhen në përputhje të plotë me parimet e trajtimit të barabartë dhe transparencës"*

Konsiderojmë se Komuna e Pejes ka shkelur ketë nen per arsye se nese e ka pasur te paqarte listen e furnizmeve ku ceket qe kemi furnizime me pelet dhe refrencen e bashkangjitur ku ceket qe ka furnizime me pelet ka mundur per te kërkuar informata shtese nga OE.

KRITERET PËR VLERËSIM

Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale	9.1 & 9.2	**Kapaciteti teknik dhe professional** **Kërkesa 1 Për (LOT-1)** **Operatori ekonomik duhet të ofroj dëshmi se ka perfunduar me sukses kontratat te natyres se ngjajeshme në vler prej 360.000.00 Euro në 3 (tri) vitet e fundit, duke filluar nga data e publikimit të Njoftimit për Kontrat.**	*Dëshmia e kërkuar dokumentare:* **Dëshmia 1 Për (LOT-1)** **Një listë te kontratave të realizuara duke plotësuar, ANEKSIN 6 të Dosies së Tenderit ku duhet saktësuar titullin e kontratës, shumën e kontratës, datën e përfundimit dhe përfituesin si dhe listës ti bashkëngjiten referencat ose procesverbalet për kryerje të furnizimeve.**
		Kërkesa 1 Për (LOT-2) **Operatori ekonomik duhet të ofroj dëshmi se ka perfunduar me sukses kontratat te natyres se ngjajshme në vler prej 150.000.00 Euro në 3 (tri) vitet e fundit, duke filluar nga data e publikimit të Njoftimit për Kontrat.**	**Dëshmia 1 Për (LOT-2)** **Një listë te kontratave të realizuara duke plotësuar, ANEKSIN 6 të Dosies së Tenderit ku duhet saktësuar titullin e kontratës, shumën e kontratës, datën e përfundimit dhe përfituesin si dhe listës ti bashkëngjiten referencat ose procesverbalet për kryerje të furnizimeve.**

RAPORTI I KOMISIONI VLERËSUES

REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVO
REPUBLIKA KOSOVA

KOMUNA E PEJËS
MUNICIPALITY OF PEJA
OPŠTINA PEČ

ZYRA E PROKURIMIT
KOMUNA E PEJËS

NJOFTIM MBI VENDIMIN E AUTORITETIT KONTRAKTUES

Sipas Nenit 43.7 dhe 44.2 të Rregullave dhe Udhëzuesit Operativ te Prokurimit Publik

Titulli i kontratës i dhënë nga autoriteti kontraktues: : Furnizim me lënd djegëse - Dru dhe Pelet

LOT 1- Furnizim me lënd djegëse - Dru

LOT 2- Furnizim me lënd djegëse - Pelet

Nr. i prokurimit [1]	**635-23-8135-1-1-1**
Nr i brendshëm	**635/23/060/111**

Radhë	**Lënda / grupi: LOT 1- Furnizim me lënd djegëse - Dru**	**Çmimi total i ofertës (me TVSH)**
1.	**" FENIKS-A " SH.P.K.**	**158.400.00**
2.	" AOME " SH.P.K	222.000.00
3.	Metë Muriqi B.I.	224.000.00

Radhë	**Lënda / grupi: LOT 2- Furnizim me lënd djegëse - Pelet**	**Çmimi total i ofertës (me TVSH)**
1.	**" WOOD COMPANY " SH.P.K.**	**71.000.00**
2.	N.T.P."GRESA - COMMERCE "	79.200.00
3.	Grup i Operatorëve Ekonomik KIGA SH.P.K.; LIKI GROUP SH.P.K.	71.125.00
4.	Grup i Operatorëve Ekonomik Petrol Company - SH.P.K.; Bek Fluids L.L.C.	68.475.00
5.	URANIKU-SG SH.P.K	82.500.00
6.	" FENIKS-A " SH.P.K.	92.500.00

Rezultati i aktivitetit te prokurimit:

KOMUNA E PEJES shpërblen per

Lot 1 me kontratë **" FENIKS-A " SH.P.K."**ne vlere totale te ofertës: **158.400.00**

Lot 2 me kontratë **" WOOD COMPANY " SH.P.K.** ne vlere totale te ofertës: **71.000.00**

Data: **05.10.2023**

Milot Gashi
Menaxher i Prokurimit

INFORMACIONET SHTESË TË MARRA ME ANË TË SQARIME TË KËRKUARA NGA EKSPERTI SHQYRTUES/TEKNIK

VLERËSIMI SIPAS NENIT 4.1.26 TË LPP

VENDIMET E MËPARSHME TË OSHP LIDHUR ME RASTET E NGJASHME

ARSYETIMI PËR DEVIJIM NGA PRAKTIKA E MËPARSHME

PËRGJIGJE NË PRETENDIMET ANKIMORE TË OE ANKUES - **Petrol Company - SH.P.K.**

Autoriteti Kontraktues – Komuna e Pejës gjatë këtij aktiviteti të prokurimit ka zbatuar procedure të hapur, kontratë publike kornizë-furnizim. Vlera e parashikuar e kontratës 340.000.00 Euro, Vlera Totale e 2 Loteve , LOT 1- Furnizim me lëndë djegëse – Dru Vlera : 240.000.00 Euro, LOT 2- Furnizim me lënd djegëse- Pelet Vlera: 100.000.00 Euro. Kriteret e Dhënies së kontratës Tenderi i përgjegjshëm me **Çmimin më të ulët.**

Ankesa është parashtruar për (Lot 2)- LOT 2- "Furnizim me lëndë djegëse – Pelet"

Pretendimet kryesore ankimore kanë të bëjnë kundër propozimit për dhënie të kontratës, përkatësisht kundër arsyetimit të eliminimit, ku AK-përmes Letrës standarde për tenderuesin e eliminuar të datës 05.10.2023 potencon tenderi juaj është refuzuar për këto arsye:***"Gjate Vlerësimit te ofertës se juaj nga komisioni vlerësues ka konstatuar se ju nuk keni përmbushur kriteret e kërkuara ne DT dhe NJ.K, Eleminimi 1: Ne dosjen e tenderit janë kërkuar Operatori ekonomik duhet të ofroj dëshmi se ka përfunduar me sukses kontratat te natyrës se ngjashme në vlerë prej 150.000.00 Euro në 3 (tri) vitet e fundit, duke filluar nga data e publikimit të Njoftimit për Kontratë. Ndërsa në ofertën e juaj te dorëzuar me datën 13.09.2023 keni prezantuar kontrata tjera qe nuk kanë te bëjnë me natyrën e punës se furnizimit me PELET apo DRU siç është kërkuar nga A.K ne D,T andaj me keqardhje ju njoftojmë se oferta juaj është e pa përgjegjshme dhe eliminoheni nga ky A.P".*** Kundër njoftimit B58 njoftim mbi vendimin e Autoritetit Kontraktues OE ankues paraqet kërkesë për rishqyrtim. AK me datë 10.10.2023 nëpërmjet vendimit refuzon kërkesën për rishqyrtim si të pa bazuar.

Pas administrimit dhe shqyrtimit të shkresave të lëndës kundrejt pretendimeve ankimore, sqarojmë se operatori ekonomik ankues pretendon se AK ka vepruar në kundërshtim me nenin 1,6, 7, 59, 60 dhe 72 të LPP-së.

Lidhur me pretendimin e OE ankues se është eliminuar pa të drejt nga ana e AK-së edhe pse janë dorëzuar lista e furnizimeve dhe kontratave për furnizime me derivate dhe PELET.

Ekspertja shqyrtuese, sqaron se AK ka kërkuar tek kërkesat e III.2.4) Kapaciteti teknik dhe profesional ka kërkuar:

1.Për (LOT-2) Operatori ekonomik duhet të ***ofroj dëshmi se ka përfunduar me sukses kontratat të natyrës se ngjajshme në vlerë prej 150.000.00 Euro në 3 (tri) vitet e fundit, duke filluar nga data e publikimit të Njoftimit për Kontratë.***

Dëshmia e kërkuar dokumentare:

1.Për (LOT-2) Një listë te kontratave të realizuara duke plotësuar, ANEKSIN 6 të Dosjes së Tenderit ku duhet saktësuar titullin e kontratës, shumën e kontratës, datën e përfundimit dhe përfituesin si dhe listës ti bashkëngjiten ***referencat*** *ose procesverbalet për kryerje të furnizimeve.*

Ekspertja shqyrtuese, sqaron se grupi i operatorëve ekonomik ankues ka dorëzuar me tender dokumentin me titull "LISTA E FURNIZIMEVE.pdf", ku në mesin e kësaj liste të furnizimeve janë gjithsej gjashtë (6) kontrata në bazë të titullit të kontratave, ku vetëm kontrata me numër rendor 1 me titull *"Furnizim me derivate të naftës dhe Pelet"* dhe referenca e lëshuar për këtë kontratë është në vlerë 38,283,106.70 euro (mbi 38 milion euro).

Provë; Lista e furnizimeve nga GOE ankues bashkangjitur me ofertë dhe referenca .

Lista e furnizimeve Te realizuara ne 3 vitet e fundit

NR.	Titulli i kontrates	Data e nenshkrimit te kontrates	Vlera e ekzekutuar e kontrates	Emri i Bleresit	E-maili i Bleresit	Nurmi i telefonit te Bleresit
1	Furnizim me derivate te naftes dhe Pelet	Data e nenshkrimit 11.05.2019 eshte aktive	Vlera e ekzekutuar prej 01.05.2020 – 30.04.2023 eshte 38,283.106.70 Euro	DHF Company Shpk	info@dhfcompany.com	044/127711
2	Furnizim me derivate	Data e nenshkrimit 01.05.2019 eshte aktive	Vlera e ekzekutuar prej 01.05.2020 – 30.04.2023 eshte 2,254.027.39 Euro	Lika Trade Shpk	likatrade@hotmail.com	049/424444
3	Furnizim me derivate te naftes	Data e nenshkrimit 20.07.2019	Vlera e ekzekutuar prej 01.05.2020 – 30.04.2023 eshte 767.365.62 Euro	Rukolli Shpk	gimrukolli@gmail.com	049/444256
4	Furnizim me derivate te naftes	Data e nenshkrimit 30.11.2019	Vlera e ekzekutuar prej 01.05.2020 – 30.04.2023 eshte 628.235.24 Euro	Alfa-i Shpk	lulzim.jahaj@alfa-i.com	044/259952
5	Furnizim me derivate	Data e nenshkrimit 30.11.2019	Vlera e ekzekutuar prej 01.05.2020 – 30.04.2023 eshte 1.126.611.97 Euro	Joos & Krasniqi Baze Shpk	info@jooskrasniqi.com	049/766804
6	Furnizim me lende djegese diesel per kaldaja si dhe motor diesel	Data e nenshkrimit 11.08.2021	Vlera e ekzekutuar prej 01.01.2022 – 30.04.2023 eshte 5.144.212.15 Euro	Korporata Energjetike e Kosoves SH.A	Bujar.Hundozi@kek-energy.com	044/149120
7			Totali: **48,203,559.10 Euro**			

Nënshkrimi i Operatorit Ekonomik _____

Vula _____

DHF COMPANY

Data: 16.06.2023

Subjekti: Referncë per Petrol Company Shpk

Petrol Company ka furnizuar DHF Company Shpk me derivate te naftes dhe me Pelet per nevojat e DHF-së ne baze te kontrates se nenshkruar me titull:Furnizim me derivate te naftes dhe Pelet.

Gjate implemtimit te kontrates Petrol Company ka tregu profesionalizem perkushtim ne kerkesat dhe nevojat si kontraktor,prandaj ne ju rekomandojme Petrol Company Shpk klienteve qe kane kerkesa per keto lloje sherbimesh.

Qarkullim per periudhen 01.05.2020 deri me 30.04.2023 është 38,283,106.70 Euro

DHF Company Shpk

DHF - COMPANY - Peja

Andaj bazuar në listën e kontratave të bashkangjitur si më lartë, si dhe titullin e aktivitetit të prokurimit, përkatësisht për ***"LOT 2- Furnizim me lënd djegëse – Pelet"***, kërkesat të cilat AK i ka vendosur në dosjen e tenderit, **ekspertja shqyrtuese** vlerëson se vetëm kontrata me numër rendor 1***."Furnizim me derivate të naftës dhe Pelet"*** *me vlerë prej 38.283.106.70 euro,* mund ta mbuloj kërkesën e autoritetit kontraktues prej 150.000.00 Euronë 3 (tri) vitet e fundit për shkak se referenca për këtë kontratë është lëshuar në emër të pranimit të furnizimeve të derivateve të naftës dhe **peletit**. Andaj, AK me rastin e kërkimit të sqarimeve nga OE ankues mund të kërkoj këtë kontratë për qëllim të vlerësimit dhe krahasimit të tenderëve sipas kërkesës së vendosur në dosje së tenderit konform nenit 59 dhe 72 të LPP-së.

Prandaj në mbështetje të asaj që u përshkrua si më lartë, sqarimeve dhe provave të bashkangjitura si më lartë, ekspertja shqyrtuese i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE

ankues të aprovohet si e bazuar, ndërsa propozoj që lënda të kthehet në **Ri Vlerësim.**

REKOMANDIMI I EKSPERTIT SHQYRTUES

Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues të aprovohet si e bazuar, të anulohet njoftimi për dhënie të kontratës dhe rekomandon që lënda të kthehet në rivlerësim.

Raporti i ekspertizës ti dorëzohet:

- Autoritetit Kontraktues – **KOMUNA E PEJES**
- Panelit Shqyrtues – OSHP
- OE ankues – **Petrol Company - SH.P.K.**

REPUBLIKA E KOSOVËS ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKI PRISHTINË/A REPUBLIKA KOSOVA

Majlinda Bedrolli